



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 42, Datë 14.02.2025

MBI

DHËNIEN E AUTORIZIMIT TË ERE-S PËR VENDOSJEN E KUOTAVE TË SHOQËRISË “KALISI HYDROPOWER” SH.P.K. SI MJET PËR GARANTIMIN E DETYRIMIT NDAJ TË TRETËVE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 9, pika 8, dhe 10 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.02.2025, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 1114/2 prot., datë 13.02.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “KALISI HYDROPOWER” sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të saj si mjet (barrë siguruese) për garantimin e përmbushjes së detyrimeve ndaj “RAIFFEISEN BANK” sh.a.”

Konstatoi se:

- Shoqëria “KALISI HYDROPOWER” sh.p.k. është licencuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 71, datë 22.04.2020, i ndryshuar, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Veleshica 1” dhe “Veleshica 2”.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 212/4 prot., datë 08.03.2024, shoqëria ka paraqitur kërkesën për dhënien e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të saj si mjet (barrë siguruese) për garantimin e përmbushjes së detyrimeve ndaj “RAIFFEISEN BANK” sh.a.
- ERE ka kërkuar nga shoqëria “KALISI HYDROPOWER” sh.p.k. plotësimin e dokumentacionit dhe sqarime mbi statusin e kuotave dhe kredinë bankare. Shoqëria ka

depozituar dokumente shtesë, por nuk ka dhënë përgjigje të plotë mbi kredinë, duke çuar në organizimin e një seance dëgjimore më 18.11.2024 me RAIFFEISEN BANK.

- Pas seancës, banka ka konfirmuar financimin e projektit për Hec Veleshica 1 dhe 2 me dy kredi (2020 dhe 2023), të siguruara me marrëveshje siguroese. Meqë të dyja marrëveshjet janë për të njëjtin qëllim dhe bankën si kredihënës dhe barrëmarrës, kërkohet miratimi nga ERE për të dy marrëveshjet meqënëse bëhet fjalë për të njëjtin projekt.
- Pas analizimit të kërkesës dhe dokumentacionit, rezulton se shoqëria ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar në nenin 8, pika 1 dhe 2 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021.
- Shoqëria ka shlyer detyrimet për pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.
- Dhënia e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë “KALISI HYDROPOWER” sh.p.k. si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.
- Për shkak të natyrës që ka vendosja e një mjeti të tillë mbi kuotat për garantimin e detyrimit përkatës nga i licencuari, vlerësohet që t’i lihet kusht shoqërisë që të njoftojë ERE-n për heqjen e barrës siguroese mbi kuotat ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Dhënien e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të shoqërisë “KALISI HYDROPOWER” sh.p.k. si mjet (barrë siguroese) për garantimin e përmbushjes së detyrimeve ndaj “RAIFFEISEN BANK” sh.a. (për kontratat datë 26.08.2020 dhe 22.07.2023).
2. Dhënia e Autorizimit nga ERE sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi nuk e çliron shoqërinë “KALISI HYDROPOWER” sh.p.k. nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

3. Shoqëria “KALISI HYDROPOWER” sh.p.k. të njoftojë ERE-n për heqjen e barrës siguroese mbi kuotat ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm.
4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.
5. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “KALISI HYDROPOWER” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI